

## Simpoziumi i 22-të i Dhomave të Mjekëve të Evropës Qëndrore dhe Lindore

11-12 Shtator 2015

Tiranë

Nga datat 11-12 Shtator 2015, pranë Hotel Boutique "Kotoni" në Tiranë u zhvillua Simpoziumi i 22<sup>të</sup> i Dhomave të Mjekëve të Evropës Qëndrore dhe Lindore (ZEVA).

ZEVA është një Simpozium i rëndësishëm ndërkombëtar i përfaqësuesve të vetrregullimit dhe vetqeverisjes së profesioneve mjekësore. Në këtë simpozium marrin pjesë vende të tilla si Gjermania, Austria, Republika Çeke, Polonia, Rumania, Kroacia, Bullgaria etj. Është krijuar pas rënies së perdes së hekurt midis lindjes dhe perëndimit. Qëllimi është të lehtësoj komunikimin dhe shkëmbimin e ideve dhe përvojave midis anëtarëve të rinj dhe të vjetër të kësaj pjese të Evropës.

Ai mbetet një platformë e diskutimit të temave të ndryshme, duke siguruar një zë të fuqishëm të bashkësisë së mjekëve, nëpërmjet formulimit të deklaratave të përbashkëta.

Asnjë pjesëmarrës nuk ka drejtimin e përhershëm të Forumit, por anëtarët e tij e marrin atë me rradhë si pritës të takimit vjetor.

Fjalën e hapjes në këtë Simpozium e mbajti **Dr. Fatmir Brahimaj**, President i Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë ku theksoi rëndësinë e këtij aktivitetit vjetor, si dhe bëri një përshkrim të shkurtër të situatës së sistemit shëndetësor në Shqipëri *"Ne po zhvillojmë strategjinë mjekësore të vendit tonë. Kjo është një sfidë e madhe, e cila kërkon ngritjen e strukturave të ndryshme të nevojshme. Sfidat janë përfshirë aspekte të ndryshme si politikat e sigurimit shëndetësor, menaxhimi shëndetësor, kontrolli i cilësisë, kreditimi, licensimi, monitorimi, edukimi i vazhdueshëm mjekësor, standardizimi, akreditimi i institucioneve shëndetësore, mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore, etj. Në këtë proces, UMSH dhe shoqatat e tjera profesionale janë të përfshira aktivisht në dhënien e kontributit të tyre duke u fokusuar vetëm në aspektet tekniko-profesionale"*.

Gjithashtu, Dr. Brahimaj ritheksoi rëndësinë e Edukimit të Vazhdueshëm Mjekësor si një nga temat që do të diskutohej gjerë në këtë Simpozium nga të gjithë vendet pjesëmarrëse.

Pas përfundimit të fjalës së hapjes nga Presidenti i UMSH-së, fjalën e mbajti **Z. Ilir Beqaj**, Ministër i Shëndetësisë, i cili përshëndeti këtë takim. Z. Beqaj bëri një përshkrim të përgjithshëm të nismave ligjore që Ministria e Shëndetësisë kishte ndërmarrë në funksionimin sa më të mirë të Urdhrave të Profesionistëve, si dhe të reformave të tjera që vet kjo Ministri ka ndërmarrë në lidhje me profesionistët e shëndetësisë.

**Znj. Albana Vokshi**, Kryetare e Komisionit Parlamentar të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë të Kuvendit të Shqipërisë ishte e ftuara e radhës që mori fjalën në këtë takim. Znj. Vokshi ri theksoi rëndësinë e pavarësisë dhe vetrregullimit të të gjithë Urdhrave të Profesionistëve në Republikën e Shqipërisë, si dhe mbështetjen që do t'i bëjë ky Komision gjithë profesionistëve të shëndetësisë.

E fundit që mbajti fjalën përshëndetëse ishte **Dr. Katrin Fjeldsted**, Presidente e Standing Committee of European Doctors e cila theksoi kënaqësinë e pjesëmarrjes në këtë aktivitet dhe theksoi rëndësinë që ka ZEVA si një mjet komunikimi dhe bashkëpunimi midis Dhomave të Mjekëve të Evropës Qëndrore dhe Lindore.

Në këtë Simpozium, në të gjithë Raportet Kombëtare të paraqitura nga përfaqësuesit e Dhomave të Mjekëve pjesëmarrës u përqëndrua në Edukimin e Vazhdueshëm Mjekësor dhe funksionimi i këtij procesi në vende dhe sisteme të ndryshme shëndetësore.

Tema e dytë dhe e rëndësishme që u paraqit dhe u diskutua ishte pavarësia dhe vetrregullimi mjekësor i profesionit mjekësor.

Ky Simpozium pati dhe Sesionet Shkencore ku temat kryesore ishin:

- Cross-border recognition of CME/CPD;
- Mobile health: Challenges for healthcare;
- Vaccination: The role of medical chambers and physicians/ Communication between the chambers, their members and the public;

Në datën 12 Shtator 2015, Ministri i Shëndëtsisë, Z. Ilir Beqaj priti në një takim të veçantë Znj. Katrin Fjeldsted Presidente e Standing Committee of European Doctors dhe Dr. Fatmir Brahimaj, President i Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë.

Znj. Fjeldsted e falenderoi për pritjen dhe i shprehu Ministrit të Shëndetësisë kënaqësinë për nivelin e lartë të këtij Simpoziumi. Ajo i sugjeroi se organizmi që ajo përfaqëson, në datë 18 Dhjetor 2015 ka një takim të rëndësishëm me temë Edukimi i Vazhdueshëm Mjekësor dhe më pas insistoi në rëndësinë e bashkëpunimit midis Urdhrave të Profesionistëve me institucionet shëndetësore për mbarëvajtjen e sistemeve shëndetësore në të gjithë Evropën.

**Shënim:** Në Rubrikën "Marrëdhëniet ndërkombëtare" së shpejti do të botohen (në anglisht) të gjitha prezantimet e paraqitura në këtë Simpozium.